



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.NR. 289/10

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Raim Aljija kandidat për deputet në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjëska Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Prizreni, që ka të bëjë me tërheqjen nga lista e kandidatëve, në seancën e mbajtur me datë 26.11.2010 mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë apeli si i pasafatshëm

ARSYETIM

Raim Aljija kandidat për deputet në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjëska Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Prizreni, ka parashtruar apel për tërheqja nga lista e kandidatëve për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i apelit ka deklaruar se është regjistruar pa njohuri të mëparshme apo ndonjë konsultim për të kandiduar nga radhët e BSDAK-se, duke shtuar se asnjëherë nuk ka qene anëtar i asnjë subjekti politik dhe në të ardhmen nuk dëshiron të jete dhe se pa pëlqimin e tij gjendet në mesin e listës me numër rendor 20.

Parashtruesi i apelit kërkon që PZAP-i të shqyrtoj ankesën e tij dhe të bëjë tërheqjen nga lista e kandidatëve për Zgjedhjet Parlamentare të Kosovës.

FAKTET

PZAP ka pranuar një apel më datë 23.11.2010 nga Raim Aljija kandidat për deputet ne Parlamentin e Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Bosnjaska Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK) nga Prizreni, i cili kërkon tërheqjen nga lista e kandidateve nga ky subjekt politik.

Parashtruesi i apelit ka pohuar që kandidimi i tij është bërë pa pëlqimin e tij, dhe duke pasur parasysh se ai punon si bashkëpunëtor profesional në KK-Prizren, ai nuk dëshiron të kandidoj për zgjedhje te përgjithshme.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073),

Neni 122 pika c) LZP përcakton:

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të më poshtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.

c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;

Lista e kandidatëve konsiderohet të jetë e certifikuar nga KQZ-ja në kohën e tërheqjes së shortit më 20 nëntor 2010, në ora 17:00 ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë pas certifikimit gjë që nuk e ka bërë Kandidati Raim Aljij nga BSDAK-ja.

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse apeli në PZAP është pranuar më datë 23.11.2010, ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 289/2010 më datën 26.11.2010.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

